

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Avdi Dinaj kryetar kolegji, Nesrin Lushta dhe Emine Kaçiku, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve Sh.H. , S.H. dhe R. Sh. për shkak të vepres penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve,substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa i i pandehuri Sh. H. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi,kontroll,posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga mbrojtësit e të akuzuarve Sh. H. dhe S.H. av.H. P. dhe av. A.A., ndërsa av.B. E. mbrojtësi i të akuzuarit R.Sh., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, PKr.nr.478/2016 datë 23.11.2016 dhe aktvendimit te Gjykates së Apelit në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda Pn1.nr.2022/2016 date 2.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.12.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë te mbrojtësve të të akuzuarve Sh.H., S.H.dhe R. Sh., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda, PKr.nr.478/2016 datë 23.11.2016 dhe aktvendimit te Gjykates së Apelit në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda Pn1.nr.2022/2016 date 2.12.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, të akuzuarit Sh. H., S.H. dhe R.Sh., i ka shpallur fajtor për shkak të vepres penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të pandehurin Sh.H. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK , ashtu që të akuzuarin Sh.H.e gjykon me dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet dhe dënim me gjobë në shumën prej 14000(katërmëdhjetëmijë)€, të akuzuarin S.H. e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 viteve dhe dënim me gjobë në shumë prej 6000(gjashtëmijë)€, dhe të akuzuarin R.Sh. me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2(dy)vitesh e 3 (tre) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 6300 (gjashtëmijëetreqind) €, ndërsa me aktvendim të veçantë PKR.nr. 478/2016 datë 23.11.2016, të akuzuarve iu ka vazhduar paraburgimin pas shpalljes së aktgjykimit e deri në plotëfuqishmërinë e tij, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar, konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1.1, 1.2, 1.2.3 të KPP-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti i Krimeve të Rënda, Pn1.nr.2022/2016 date 2.12.2016, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe është vërtetuar aktvendimi i shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Sh.H.dhe S.H. av.H.P.dhe av. A.A.,për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale nga neni 187 par.1 nënpar 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 dhe nenit 367 par.3.6 dhe 7 të KPPk –së dhe shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor mbi vazhdimin e paraburgimit,me propozim që ti ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njejtut të mbrohen në liri, av. B.E. mbrojtësi i të akuzuarit R.Sh., për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të nenit 5,185 dhe 367 të KPPK-së,mbi vazhdimin e paraburgimit, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që të akuzuarit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njejtut të mbrohet në liri deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit.

Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të akuzuarit , ka dhene Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.III.nr.65/2016 datë 16.12.2016, në të cilën propozon që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë te refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësit e të akuzuarve në kërkesat e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë pretendojnë se në aktvedimet e kundërshtuara nuk qëndrojnë asnjë nga arsyet ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit, sipas mbrojtësve të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, gjykata është dashur që ti favorizoi të akuzuarit,e jo tju vazhdoi paraburgimin ndersa si shkelje të ligjit penal mbrojtësit theksojnë se gjykatat vetëm i kanë parafrazuar dispozitat ligjore,të pargumentuara me prova dhe fakte konkrete duke supozuar se po të gjenden të akuzuarit në liri do ta përsërisin veprën penale pa u plotësuar kushtet e nevojshme për këtë masë të sigurisë së pranisë së të akuzuarve në procedurë, e kjo sipas tyre i bën aktvendimet e kundërshtuara të paqëndrueshme .

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat e mbrojtësve për mbrojtje të ligjshmërisë se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit kundër të akuzuarve nuk janë të bazuara, sepse në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar për vepra të rënda penale dhe janë gjykuar me dënimet e cekura më lartë, prandaj duke i pasur parasysh karakteristikat e tyre personale, si dhe faktin se tek të njejtit është gjetur sasi shume e madhe e substancës narkotike 55 kg mariuhanë,e cila kishte destinacion për shitje jashtë shtetit si dhe mënyra e veprimit të tyre, jep arsye për të besuar ekziston frika e bazuar se me gjetjen e të akuzuarve në liri, të njejtit do të mund ta përsërisin veprat penale të njejtë apo të ngjashme.

Andaj edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, qëndrojnë bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit, kundër të akuzuarve siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë, si dhe kanë dhënë arsye të mjaftueshme, të qarta dhe konkrete mbi faktet vendimtare për bazën ligjore për të cilën iu kanë vazhduar paraburgimin të akuzuarve konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPP, të cilat si të drejta dhe të bazuara i vlerëson edhe kjo Gjykatë, ngase aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkele të ligjit penal.

Nga sa u parashtrua më lartë në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.325/2016, më 19.12.2016

B.profesionale,
Minire Xhambazi

Kryetar i kolegjit,
Avdi Dinaj